



KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA
KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS
TUŽILAČKI SAVET KOSOVO
KOSOVO PROSECUTORIAL COUNCIL

ZYRA E PROKURORIT DISIPLINOR/ KANCELARIJA DISIPLINOG TUŽIOCA/ OFFICE OF THE DISCIPLINARY COUNSEL

ODA E AVOKATEVE TË KOSOVËS

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Në mes të:

Zyrës së Prokurorit Disiplinor (ZPD), të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) e Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK) dhe Odës së Avokateve të Kosovës (OAK).

Palët nënshkruese të kësaj Marrëveshje të Bashkëpunimit pajtohen si në vijim:

Neni 1

1. Zyra e Prokurorit Disiplinor (ZPD) dhe Oda e Avokateve të Kosovës (OAK), me këtë Marrëveshje Bashkëpunimi krijojnë raporte të partneritetit dhe bashkëpunimit në hetimin e sjelljeve të pahijshme përmes:

1.1 Shkëmbimit të informatave;

- 1.2 Bashkëpunimit në hetimin e rasteve të sjelljes së pahijshme kur pohohet përfshirja e gjyqtareve, gjyqtareve porotë, prokurorëve, avokateve dhe praktikanteve të avokatisë;
- 1.3 Ndhmën dhe asistencë teknike të ndërsjellët në procesin e hetimeve preliminare;
- 1.4 Këshillimin e përbashkët në zgjidhjen e rasteve dhe problemeve të ndryshme që kanë të bëjnë me hetimin e sjelljes së pahijshme në gjykata, prokurori dhe në zyrat e avokateve;
- 1.5 Si dhe format tjera të mundshme të bashkëpunimit.

Neni 2

ZPD dhe OAK do të bashkëpunojë ngushtë në evidentimin, sigurimin e informacioneve dhe provave relevante të rasteve të sjelljes së pahijshme të kryera nga gjyqtaret, gjyqtaret porotë, prokuroret, avokatet dhe praktikantet e avokatisë.

Neni 3

- 3.1 ZPD do t'i trajtoj me prioritet të gjitha informacionet e pranuar nga OAK.
- 3.2 OAK do t'i trajtoj me prioritet të gjitha informacionet e pranuar nga ZPD.

Neni 4

- 5.1 Palët nënshkruese të kësaj Marrëveshje bashkëpunimi pajtohen që të zgjerojnë fushat e bashkëpunimit në hetimin e sjelljeve që kanë të bëjnë në mos respektimin e Kodit të Etikës Profesionale, profesionit ligjor dhe në kundërshtim me aktet normative:
 - 5.1.1 Trajnimeve të përbashkëta;
 - 5.1.2 Bashkëpunimit në lidhje me hartimin e akteve nënligjore relevante të nevojshme për funksionimin e ZPD-së dhe OAK;
 - 5.1.3 Pjesëmarrjes në seminare dhe forma të tjera të avancimit të diturive teorike dhe praktike.
 - 5.1.4. Palët do të bëjnë njoftimin lidhur me rastet në të cilat janë në kompetencën e tyre. Palet do të bashkëpunojnë në ofrimin e ndihmës në sigurimin

Neni 5

Parimi i konfidencialitetit dhe ruajtjes së fshehtësisë të informatave dhe dokumenteve do të zbatohet me përpikëri, duke mënjanuar çfarëdo situatë të konfliktit të mundshëm të kompetencave.

Neni 6

Bashkëpunimi do të realizohet në mes të zyrtareve kontaktues si dhe në pajtueshmëri të plotë me zotimet që dalin nga kjo Marrëveshje.

Neni 7

Asnjë nga veprimet e cekura më lartë që adresojnë format e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve (ZPD dhe OAK) nuk do të përdoren për qëllime tjera, jashtë mandatit ligjor të ZPD-së dhe OAK.

Neni 8

9.1 Kjo marrëveshje mund të shfuqizohet me paralajmërimin e njëjës palë në afatin prej 3 muajsh;

9.2 Nëse dispozitat e kësaj Marrëveshje shkelen apo keqpërdoren, Marrëveshja automatikisht do të shfuqizohet.

Neni 9


Kjo Marrëveshje hynë në fuqi në momentin e nënshkrimit të saj nga Drejtori i ZPD-së dhe Kryetari i OAK-së.

Neni 10


ZPD dhe OAK do të mbajnë nga dy kopje të kësaj Marrëveshje.

Prishtinë, 09 qershor 2014.

Nënshkruesit e kësaj Marrëveshje:



Av. Ibrahim Z. DOBRUNA, Kryetar
Oda e Avokateve të Kosovës



Zef PRENDRECAJ, Drejtor
Zyra e Prokurorit Disiplinor